



ODA EKONOMIKE
E KOSOVËS | KOSOVA CHAMBER
OF COMMERCE



UNOPS

SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË NË SEKTORIN PRIVAT TË KOSOVËS

Prishtinë, 2021



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË NË SEKTORIN PRIVAT TË KOSOVËS

Oda Ekonomike e Kosovës

Siguria dhe shëndeti në punë në sektorin privat të Kosovës

2021

Botues:

Oda Ekonomike e Kosovës

Autore:

Muela Ibrahim, Udhëheqëse e Departamentit për Politika dhe Analiza Ekonomike

Ekipi ndihmes hulumtues:

Blerona Krasniqi, Erkanda Kaliqanaj, Eranda Abdullahu, Rrezarta Jetullahu, Elita Ferati

“Ky studim është realizuar në kuadër të projektit të UNOPS-it “Promovimi i Punës së Denjë përmes Forcimit të Menaxhimit të SSHP dhe Dialogut Social në Kosovë”, financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) përmes Ambasadës së Suedisë në Prishtinës.

Oda Ekonomike e Kosovës

Siguria dhe Shëndeti në Punë në Sektorin
Privat të Kosovës

Prishtinë 2021

Përmbajtja

Figurat.....	6
Tabelat.....	7
Përmbledhja Ekzekutive.....	9
1. Hyrja.....	11
2. Metodologjia	13
3. Gjetjet e Anketës.....	17
3.1 Zbatimi dhe sfidat e bazës ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë	17
3.2 Procedurat dhe politikat e sigurisë dhe shëndetit në punë	26
3.3 Gjendja aktuale rreth kushteve për sigurinë dhe shëndetin në punë nga ana e punëdhënësve	32
3.4 Gjendja aktuale e zbatimit të udhëzimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë nga ana e punonjësve.....	35
3.5 Kompetenca e kompanive për sigurinë dhe shëndetin në punë	39
3.6 Performanca e kompanive kosovare në raport me sigurinë dhe shëndetin në punë.....	43
3.7 Tendencat e kompanive për përmirësim	47
3.8 Udhëheqësia e kompanive për trajtimin e çështjeve që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë.....	49
4. Konkluzione	51
5. Rekomandime	53
Shtojca 1.....	55
Pyetësor për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sketorin Privat të Kosovës	55

FIGURAT

Figura 1: Mostra e stratifikuar në bazë të sektorëve dhe rajoneve	14
Figura 2: Mostra e stratifikuar në bazë të madhësisë së kompanive dhe strukturës gjinore.....	15
Figura 3: Mostra e stratifikuar në bazë të numrit të femrave të punësuar në kompani.....	16
Figura 4: Njohuritë për kërkesat e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë.....	18
Figura 5: Njohuritë për kërkesat e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë në bazë numrit të femrave të punësuar në kompani.....	19
Figura 6: Kushtet e punës dhe masat për siguri dhe shëndet në punë.....	20
Figura 7: Plotësimi i kushteve të punës dhe masave për siguri dhe shëndet në punë në bazë të numrit të femrave të punësuar në kompani	21
Figura 8 :Vështirësitë në zbatimin e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë	22
Figura 9: Vështirësitë në zbatimin e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë në bazë të numrit të femrave të punësuar në kompani.....	23
Figura 10: Sfidat gjatë zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë.....	24
Figura 11: Vizitat në kompani nga inspektorati i punës.....	25
Figura 12: Politika e dokumentuar e shëndetit dhe sigurisë në punë	26
Figura 13: Dokumentimi i përmbushjes së një operacioni	27
Figura 14: Dokumentimi i përmbushjes së një operacioni në bazë të femrave të punësuar në kompani	28
Figura 15: Induksioni i sigurisë për punëtorët.....	29
Figura 16: Masat parandaluese të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale	30
Figura 17: Opsionet e disponueshme në kompani në rast rreziku të sigurisë dhe shëndetit.....	31
Figura 18: Përqindja e qarkullimit që përdoret për investime të sigurisë dhe shëndetit në punë	32
Figura 19: Rritja e investimeve në tre vitet e ardhshme.....	33
Figura 20: Masat e ndërmarra për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve	34
Figura 21: Këshillimi dhe pikëpamjet e punëtorëve për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë	35
Figura 22: Raportimi i shqetësimeve të punëtorëve	36
Figura 23: Aplikimi i udhëzimeve të punëdhënësit nga punëtorët.....	37
Figura 24: Përmbajtja e detyrave dhe udhëzimeve nga punëtorët për sigurinë dhe shëndetin në punë	38
Figura 25: Investimet në trajnime	39
Figura 26: Plani formal i trajnimit	40
Figura 27: Monitorimi i planit të trajnimit.....	40
Figura 28: Mbajtja e diskutimeve formale për sigurinë, ose mbajtja e trajnimeve të tjera nga ana e kompanive	41
Figura 29: Angazhimi i punëtorëve për kryerjen e veprimtarive të sigurisë dhe shëndetit në punë...42	

Figura 30: Matja dhe monitorimi i statistikave të shëndetit dhe sigurisë në punë.....	43
Figura 31: Objektivat e shëndetit dhe sigurisë	44
Figura 32: Performanca e kompanive.....	44
Figura 33: Vlerësimi i performancës së kompanive në bazë të numrit të femrave të punësuara.....	45
Figura 34: Inspektimet e sigurisë dhe shëndetit në punë	46
Figura 35: Strategjia e kompanive për siguri dhe shëndet në punë.....	47
Figura 37: Plani për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.....	48
Figura 38: Përparimi i kompanive në përmirësimin e qështjes së sigurisë dhe shëndetit	48
Figura 40: Takimet për diskutim të qështjeve të sigurisë dhe shëndetit në punë	49
Figura 41: Angazhimi i udhëheqësve për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në vendin e punës..	50

TABELAT

Tabela 1: Testi statistikor Chi-Square për testimin e signifkances së të dhënave rreth njohurive për kërkesat e ligjit për shëndetin dhe sigurinë në punë në bazë numrit të femrave të punësuara në kompani	19
Tabela 2: Testi statistikor Chi-Square për testimin e signifkances së të dhënave rreth plotësimin të kushteve të punës dhe masave për siguri dhe shëndet në punë në bazë të numrit të femrave të punësuara në kompani.....	21
Tabela 3: Testi statistikor Chi-Square për testimin e signifkances së të dhënave rreth vështirësive në zbatimin e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë në bazë të numrit të femrave të punësuara në kompani	23
Tabela 4: Testi statistikor Chi-Square për testimin e signifkances së të dhënave rreth dokumentimit të mënyrës së përmbushjes së një operacioni nga kompanitë në bazë të numrit të femrave të punësuara	28
Tabela 5: Testi statistikor Chi-Square për testimin e signifkances së të dhënave rreth vlerësimit të performancës posedimit të një plani formal të trajnimit në bazë të numrit të femrave të punësuara..	45

Përmbledhja Ekzekutive

Siguria dhe shëndeti në punë është një proces kompleks për përmirësimin e kushteve dhe mjedisit të punës, parandalimin e lëndimeve, sëmundjeve të lidhura me punën, mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit të punëtorëve. Siguria dhe shëndeti në punë janë pjesë përbërëse e procesit të punës dhe në përgjithësi janë elemente kyçe të cilësisë së punës.

Studimi synon të analizoj gjendjen aktuale të zbatimit të Ligjit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij nga kompanitë që operojnë në sektorin e prodhimit, ndërtimit, bujqësisë dhe energjisë, të analizojë gjendjen aktuale të kushteve të punës dhe të nxjerrë konkluzione e të japë rekomandime me qëllim përmirësimin e situatës në drejtim të zbatimit të legjislacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Mostra përbëhet nga 150 kompani, e cila pastaj është stratifikuar në shtatë rajone kryesore të Kosovës (Prishtina (18.57%), Gjakova (15.71%), Peja (15.71%), Prizreni (13.57%), Ferizaj (13.57%), Mitrovica (12.14%) dhe Gjlani (10.71%)). Mostra është dominuar nga ndërmarrjet e sektorit të prodhimit (67.61%) dhe nga ndërmarrjet e vogla me 10 – 49 punëtorë (51%).

Në bazë të të gjeturave të këtij studimi del se rreth 73.43% e kompanive operuese në sektorët dhe rajonet e lartpërmendura janë mesatarisht të informuara për kërkesat që rrjedhin ndaj tyre nga ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe se 60% e tyre i plotësojnë mesatarisht kushtet e punës duke ndërmarre masat e nevojshme.

Bizneset që operojnë në sektorin privat të Kosovës detyrimet që rrjedhin nga ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë i cilësojnë si mesatarisht të vështira për tu zbatuar, respektivisht rreth 58.33% e kompanive pjesëmarrëse në studim e kanë potencuar këtë fakt. Top sfidat me të cilat përballen kompanitë në zbatimin e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë janë: kosto e lartë e infrastrukturës për të arritur sigurinë dhe shëndetin në punë, sfidë e cila është raportuar nga 49% e kompanive, pasuar nga kostoja e lartë e trajnimit të punëtorëve në këtë drejtim, e cila është raportuar nga 46% e kompanive dhe vështirësitë në mbulimin e të gjitha shpenzimeve për kurimin e të punësuarve që kanë pësuar lëndime/sëmundje gjatë procesit të aktiviteteve të punës, e raportuar nga 40%. Në bazë të të gjeturave duket se kompanitë nuk janë duke pasur vështirësi në sigurimin e mjeteve dhe pajisjeve të duhura profesionale të punës si dhe aparaturave matëse

adekuate për punëtoret e tyre, pasi që është raportuar si sfidë vetëm nga 14% e kompanive pjesëmarrëse në studim.

Pjesa më e madhe e kompanive, përkatësisht rreth 75.35% theksuan se për përmirësim të kushteve që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në vendin e tyre të punës i dedikojnë vetëm 10.35% të qarkullimit të tyre të përgjithshëm, ndonëse 91.55% e tyre planifikojnë rritje të investimeve në këtë drejtim gjatë tre viteve të ardhshme.

Sidoqoftë, bazuar në të dhënat e studimit, 56% e kompanive e vlerësojnë si të mirë performancën e tyre në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë dhe 70% e tyre posedojnë plane për përmirësim akoma më të lartë të gjendjes.

1. HYRJA

Analiza e sigurisë dhe shëndetit në punë është thelbësore për politik-bërësit në matjen e shkallës së zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë nga ana e kompanive të sektorit privat, e gjithashtu është mjet identifikimi i masave, kushteve dhe sfidave për zbatimin e këtij ligji nga sipërmarrësit. Ky studim ofron një pasqyrë të qartë mbi gjendjen aktuale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës në sektorin privat të Kosovës dhe përpos që është një mjet shumë i rëndësishëm për politik-bërësit dhe bizneset, ai i shërben jashtëzakonisht shumë dhe publikut të gjerë. Prandaj, është e nevojshme që të rritet vetëdija e gjithë kompanive, palëve të interesit dhe publikut të gjerë për rëndësinë në arritjes së sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në vendin e tyre të punës.

Ligji NR. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë ka si objektiv përcaktimin e masave që iu garantojnë punëmarrësve siguri dhe shëndet në punë. Ky ligj ka për qëllim parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident gjatë punës, informimin dhe këshillimin në kohë, pjesëmarrjen e balancuar, formimin e punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre, përputhshmërinë ligjore si dhe përcaktimin e udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtij qëllimi. Edhe pse ligjet rregullojnë mjaftueshëm mirë një problem të tillë, shumë hulumtime tregojnë që zbatueshmëria e tyre është shumë jashtë kornizave se çfarë këto ligje përfaqësojnë.

Punëdhënësit janë përgjegjës për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve e sistemeve të kërkuara për të ofruar siguri dhe shëndet në vendin e punës. Punëdhënësi duhet të sigurojë dhe mirëmbajnë vendet e punës, impiantet, pajisjet, mjetet dhe makineritë si dhe të organizojë punën në mënyrë që të eliminojë ose kontrollojë faktorët e rrezikshmërisë në ambientin e punës. Masat parandaluese dhe mbrojtëse duhet të futen sipas renditjes vijuese të përparësisë: eliminimi i rrezikut – duke hequr ose zëvendësuar procese të rrezikshme gjatë punës, kontrollimi i rrezikut – përmes përdorimit të kontrolleve inxhinierike, minimizimi i rrezikut – përmes hartimit të sistemeve të sigurta të punës dhe masave të kontrollit administrativ ose institucional.¹

Në bazë të hulumtimeve të kryera rreth sigurisë dhe shëndetit në punë është konstatuar se kompanitë për të qenë të suksesshme dhe konkurruese duhet që ato të kenë regjistrat e shëndetit/sigurisë, të cilët duhet të jenë të plotë dhe të aplikueshëm. Këto kompani të

¹ International Finance Corporation (IFC), Environmental, Health, and Safety General Guidelines

cilat plotësojnë elementin bazik të zbatimit të drejtave të punëtorëve rrjedhimisht kanë punonjës më të kënaqur e më të shëndetshëm në aspektin fizik dhe psikologjik, me të cilët mund të arrihet performancë më e lartë në punë. Është mjedis i shëndetshëm pune ai në të cilin punonjësit dhe menaxherët bashkëpunojnë për të instaluar një proces vazhdimisht të përmirësueshëm në mbrojtje dhe promovim të shëndetit, siguri dhe mirëqenie të stafit duke krijuar kështu një atmosferë sigurie dhe koncentrim më të lartë gjatë kryerjes së detyrave nga të gjitha palët.

Ky hulumtim ka për qëllim të diagnostifikoj gjendjen aktuale në sektorin e prodhimit, ndërtimit, bujqësisë dhe energjisë në aspektin e sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe të matë njohuritë për kërkesat që rrjedhin për punëdhënësit të rregulluara me ligje përkatëse. Studimi vë në pah sfidat dhe problemet me të cilat përballet sektori privat në zbatimin e ligjit për shëndetin dhe sigurinë në punë, kushtet dhe procedurat që kompanitë zbatojnë për të parandaluar aksidentet në punë, sëmundjet nga ushtrimi i disa profesioneve si dhe paraqet nevojat për trajnim më efikas të punëtorëve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Studimi është realizuar kryesisht duke u mbështetur në të dhëna primare të mbledhura përmes anketave (mbi 150 ndërmarrje të anketuara) me kompani nga shtatë rajonet kryesore të Kosovës: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë, dhe Prizren.

Ky raport hulumtues është i organizuar si në vijim. Në seksionin vijues jepet një pasqyrë e metodologjisë që është përdorur për të realizuar hulumtimin. Seksioni 3 paraqet vlerësimet e kompanive rreth zbatimit të bazës ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe sfidat që hasen për zbatimin e kërkesave që rrjedhin nga ky ligj, duke vazhduar me procedurat dhe politikat e shëndetit dhe sigurisë, gjendjen aktuale të sigurimit të kushteve dhe zbatimit të udhëzimeve nga ana e punëdhënësve, kompetencat dhe performancat e kompanive për çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe planet e tyre për përmirësim. Ndërsa përfundon me një numër të konkluzioneve dhe rekomandimeve me qëllim përmirësimin e situatës në drejtim të zbatimit të legjisllacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

2. METODOLOGJIA

Mbledhja e të dhënave për sigurinë dhe shëndetin në punë është bërë me ndihmën e një pyetëtori, i cili është hartuar nga Oda Ekonomike e Kosovës në bashkëpunim me ekspert të jashtëm. Pyetëtori ka për qëllim të mat shkallën e zbatueshmerisë dhe performancës së kompanive në raport me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe të identifikoj nevojat dhe sfidat me të cilat përballën kompanitë e Kosovës në aspektin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Për këtë studim janë anketuar gjithsej 154 kompani që operojnë në sektorin e ndërtimit, prodhimit, bujqësisë dhe energjisë. Përzgjedhja e mostrës është bërë në mënyrë rastësore nga databaza e kompanive aktive në Kosovë e cila është marr nga ATK. Mostra është stratifikuar në shtatë (7) rajone kryesore dhe në katër (4) sektor të ekonomisë së Kosovës. Pjesëmarrje më të madhe në mostër ka sektori i prodhimit (67.7%), pasuar nga sektori i ndërtimit me rreth 21.2%, ndërsa sektori i bujqësisë dhe energjisë ndajnë përqindje të njëjtë me nga 5.63% (shih figurën 1). Sa i përket shtrirjes gjeografike të kompanive pjesëmarrëse në mostër, rajoni me pjesëmarrje më të madhe është rajoni i Prishtinës me 18.6%. Në përgjithësi, pjesëmarrja e rajoneve në mostër nuk dallon shumë. Në figurën e mëposhtme në të djathtë, shohim se rajoni i Gjakovës dhe Pejës ndajnë të njëjtën përqindje në pjesëmarrje me nga 15.71%. Gjithashtu, përqindje të njëjtë ndajnë dhe rajoni i Ferizajit dhe Prizrenit me nga 13.57%. Ndërsa, pjesëmarrje pak më të ulët në mostër në krahasim me rajonet tjera kanë rajoni i Mitrovicës (12.2%) dhe rajoni i Gjilanit (10.8%).




Figura 1: Mostra e stratifikuar në bazë të sektorëve dhe rajoneve

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Kompani të madhësive të ndryshme janë anketuar për qëllime të këtij hulumtimi si, mikro, të vogla, mesme dhe të mëdha. Në figurën e mëposhtme shohim se me përqindje më të madhe të pjesëmarrjes në mostër janë kompanitë e vogla me 10 deri 49 punëtorë (51.05%). Ndërsa, pjesëmarrje më të vogël kanë kompanitë e mëdha me mbi 250 punëtorë. Kjo mënyrë e përbërjes së mostrës është në përputhje me strukturën e ndërmarrjeve në Kosovë sa i përket madhësisë. Pasi që, pjesa dërmuese e ndërmarrjeve në Kosovë janë mikro dhe të vogla. Ndërsa, sa i përket shtrirjes gjinore në mostër, në rreth 66% të kompanive të anketuara kanë qenë meshkuj ata që kanë dhënë informatat e nevojshme për kompaninë në bazë të pyetjeve të anketës.




Figura 2: Mostra e stratifikuar në bazë të madhësisë së kompanive dhe strukturës gjinore

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Mbi gjysma e kompanive pjesëmarrëse kanë deklaruar se kanë 1 – 9 punëtore femra në kompani. ¼ e kompanive nuk kanë asnjë punëtore dhe vetëm 4.3% e kompanive kanë mbi 50 punëtore femra.




Figura 3: Mostra e stratifikuar në bazë të numrit të femrave të punësuara në kompani

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Me qëllim që të identifikohen qartë problematikat është përdorur një qasje cilësore dhe sasore gjatë përpilimit të pyetësorit i cili përbëhet nga tetë pjesë.

Studimi është realizuar duke u mbështetur kryesisht në të dhëna primare, të cilat janë grumbulluar nga një ekip anketues prej 11 personave. Metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave është F2F CAPI (intervista të drejtpërdrejta me ndihmën e kompjuterit). Grumbullimi i të dhënave ka kaluar në dy faza, së pari është bërë grumbullimi i informacioneve relevante rreth ligjit për shëndetin dhe sigurinë në punë në Kosovë nga burimet sekondare, pastaj janë grumbulluar të dhënat në terren nga bizneset kosovare. Ekipi anketues ka intervistuar bizneset në mes të muajit Janar 2021 deri në muajin Mars 2021.

Analiza dhe interpretimi i të dhënave në këtë hulumtim është mbështetur kryesisht në statistika përshkruese. Megjithatë, disa pjesë janë mbështet dhe nga statistika inferenciale, ku janë bërë teste statistikore si chi square për të evidentuar signifikancën statistikore të disa të dhënave. Për procesimin dhe analizimin e të dhënave është përdorur programi SPSS ku është analizuar dinamika e zhvillimit dhe e përmirësimit të sistemit të shëndetit dhe sigurisë, evidentimi i problemeve (barrierave), i mangësive dhe i faktorëve që vështirësojnë funksionimin normal të këtij sistemi dhe po ashtu nxjerrja e disa konkluzioneve lidhur me rrugët dhe mënyrat e eliminimit të këtyre mangësive.

3. GJETJET E ANKETËS

Në këtë seksion janë përmbledhur të gjeturat kryesore të anketës. Fillimisht, analizohet zbatimi dhe sfidat e bazës ligjore për shëndetin dhe sigurinë në punë në Kosovë. Pjesa e dytë e këtij seksioni analizon dhe prezanton procedurat dhe politikat e shëndetit dhe sigurisë. Në pjesën e tretë flitet për sigurimin e kushteve për shëndet dhe siguri në punë nga ana e punëdhënësve, ndërsa në pjesën e katërt për zbatimin e udhëzimeve për shëndetin dhe sigurinë në punë nga ana e punëmarrësve, pra analizohet të dy anët e medaljes. Më tutje, në pjesën e pestë analizohen kompetencat e kompanive për shëndetin dhe sigurinë në punë kurse në pjesën e gjashtë performanca e kompanive në raport me shëndetin dhe sigurinë në punë. Pjesa e shtatë shqyrton planet e kompanive kosovare për përmirësim dhe në pjesën e fundit është paraqitur perspektiva nga udhëheqësit e kompanive për trajtimin e çështjeve që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë.

3.1 Zbatimi dhe sfidat e bazës ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë

Kompanitë kosovare që një kohë të gjatë janë duke pasur vështirësi në zbatimin e ligjit për shëndet dhe siguri në punë, kjo kryesisht për shkak të mungesës së mjeteve financiare për të bërë investimet e nevojshme në infrastrukturë që sigurojnë shëndetin e punëtorëve dhe kostos së papërballueshme për kompanitë në krijimin e kushteve dhe plotësimin e kërkesave që rrjedhin nga ligji. Sa i përket njohurive kompanitë nuk qëndrojnë keq në këtë aspekt, pasi që një pjesë e madhe e kompanive pjesëmarrëse në hulumtim (73%), deklaruan se kanë mesatarisht njohuri për kërkesat që rrjedhin ndaj tyre nga ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë. Ndërsa, rreth 13% kanë potencuar se janë shumë të informuar për këto kërkesa. Një përqindje më e vogël e kompanive (14%) kanë pak ose shumë pak njohuri rreth ligjit përkatës.




Figura 4: Njohuritë për kërkesat e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Në bazë të analizës së të dhënave të këtij hulumtimi del se kompanitë që kanë më shumë ferma të punësuar kanë më shumë njohuri për kërkesat që rrjedhin nga ligji. Rreth 67% e kompanive që kanë të punësuar mbi 50 femra në kompanitë e tyre kanë shumë njohuri për kërkesat që duhet plotësuar. Në anën tjetër, asnjë kompani prej kategorisë që nuk kanë të punësuar femra në kompaninë e tyre nuk e ka theksuar këtë gjë. Për më tepër, për të shikuar më tutje saktësinë e këtyre të gjeturave është bërë dhe një test statistikor për të parë signifkancën e dallimeve në mes të kategorive të kompanive: me asnjë femër të punësuar; 1-9 punëtore; 10-49 punëtore; dhe me mbi 50 punëtore. Në bazë të rezultateve të testit χ^2 p vlera është 0.000 (shih tabelën 1). Meqë p -vlera=0.000 është më e vogël se p -kritike=0.05, atëherë kemi evidence statistikore/empirike të mjaftueshme për të thënë se kompanitë që kanë më shumë femra të punësuar në kompani kanë më shumë njohuri rreth kërkesave që rrjedhin prej ligjit për shëndetin dhe sigurinë në punë se sa kompanitë që nuk kanë të punësuar femra.




Figura 5: Njohuritë për kërkesat e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë në bazë numrit të femrave të punësuarra në kompani

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	41.079 ^a	9	.000
Likelihood Ratio	35.751	9	.000
Linear-by-Linear Association	8.146	1	.004
N of Valid Cases	138		

a. 11 cells (68.8%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .17.

Tabela 1: Testi statistikor Chi-Square për testimin e signifkances së të dhënave rreth njohurive për kërkesat e ligjit për shëndetin dhe sigurinë në punë në bazë numrit të femrave të punësuarra në kompani

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Pavarësisht vështirësive për t'i përmbushur kushtet dhe për t'i bërë investimet e nevojshme në infrastrukturë, kompanitë kanë arritur që ti plotësojnë ato mesatarisht duke ndërmarrë masat e nevojshme paraprakisht. Më shumë se gjysma e kompanive të intervistuarra (59%) deklaruan se mesatarisht i plotësojnë kushtet e punës. Gjithashtu, rreth 38% e kompanive kanë theksuar se janë shumë të vëmendshëm në plotësimin e kushteve të punës për shëndet dhe siguri të punëtorëve të tyre. Në anën tjetër, është vetëm një përqindje e vogël e kompanive (3%) që nuk ndërmarrin masat e nevojshme për shëndet dhe siguri në punë.




Figura 6: Kushtet e punës dhe masat për siguri dhe shëndet në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Në bazë të analizës së të dhënave duke u mbështetur në perspektivë gjinore, del se kompanitë që kanë më shumë femra të punësuar kanë plotësuar më shumë kushtet e punës për siguri dhe shëndet në punë se sa kompanitë që kanë më pak ose nuk kanë asnjë femër të punësuar në kompani. Rreth 83% e kompanive që kanë mbi 50 punëtore kanë thënë se shumë i plotësojnë kushtet e punës, pasur nga 59% e kompanive që kanë 10-49 punëtore dhe 45% e kompanive që kanë 1-9 punëtore. Gjithashtu, testi statistikor χ^2 e mbështet këtë deklaratë, pasi që p-vlera e vlerësuar=0.000 është më e vogël se p-vlera kritike 0.05 (shih tabelën 2). Në këtë rast, kemi evidencë të mjaftueshme empirike për të pranuar këtë deklaratë.




Figura 7: Plotësimi i kushteve të punës dhe masave për siguri dhe shëndet në punë në bazë të numrit të femrave të punësuarë në kompani

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	37.809 ^a	6	.000
Likelihood Ratio	43.906	6	.000
Linear-by-Linear Association	17.218	1	.000
N of Valid Cases	139		

a. 6 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .17.

Tabela 2: Testi statistikor Chi-Square për testimin e signifkances së të dhënave rreth plotësimi të kushteve të punës dhe masave për siguri dhe shëndet në punë në bazë të numrit të femrave të punësuarë në kompani

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Kompanitë kosovare kanë hasur në vështirësi të ndryshme gjatë zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga ligji për siguri dhe shëndet në punë. Rreth 23% e tyre kanë pohuar janë përballur me shumë vështirësi për të zbatuar kërkesat e ligjit. Ndërsa, mbi gjysma e kompanive pjesëmarrëse në hulumtim e kanë vlerësuar si mesatarisht të vështirë implementimin e obligimeve që rrjedhin nga ligji për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës. Sipas, një analize më të thuket rreth vështirësive të kompanive del se kompanitë që nuk kanë asnjë femër të punësuar kanë hasur në më shumë vështirësi për të kryer obligimet e nevojshme si duhet karshi ligjit sesa kompanitë që kanë më shumë femra të punësuarë.

Për këto dallime signifikante në mes të këtyre kategorive ekziston dhe evidencë empirike e cila tregohet përmes p-vlerës së vlerësuar e cila është 0.009 që është më e vogël e p-vlera kritike $p=0.05$.




Figura 8 :Vështirësitë në zbatimin e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.




Figura 9: Vështirësitë në zbatimin e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë në bazë të numrit të femrave të punësuara në kompani

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	22.024 ^a	9	.009
Likelihood Ratio	22.374	9	.008
Linear-by-Linear Association	11.779	1	.001
N of Valid Cases	139		

a. 9 cells (56.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .47.

Tabela 3: Testi statistikor Chi-Square për testimin e signifkances së të dhënave rreth vështirësive në zbatimin e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë në bazë të numrit të femrave të punësuara në kompani

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Me qëllim të krijimit të një pasqyrë të qartë rreth sigurisë dhe shëndetit në punë në këtë hulumtim janë identifikuar sfidat kryesore me të cilat janë përballur më së shumti kompanitë. Rreth gjysma e bizneseve të anketuara kanë theksuar se si pengesë kryesore për zbatimin e ligjit për siguri dhe shëndet në punë është kostoja e lartë e infrastrukturës së kërkuar për t'i përmbushur kushtet për siguri dhe shëndet (49%), si pengesë e dytë më e raportuar nga kompanitë është kostoja e lartë e trajnimit të punëtorëve (46%), pasuar nga kërkesat e larta dhe të papërbalueshme për infrastrukturë (43%), duke vazhduar me vështirësitë që kompanitë hasin për mbulimin e të gjitha shpenzimeve për kurimin e të punësuarve të cilët kanë pësuar lëndime në punë apo sëmundje të ndryshme gjatë procesit të punës (40%).

Mos-bindja e kërkesave dhe udhëzimeve të punëdhënësve nga ana e punëtorëve (30%), kostoja e lartë për të dëshmuar kushtet e punës (28%) si dhe vështirësitë në pajisjen e punëtorëve me mjetet profesionale të punës dhe aparaturat matëse adekuate (14.18%) raportohen po ashtu të jenë pengesa të shfaqura gjatë zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës por në një shkallë më të ulët.




Figura 10: Sfidat gjatë zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Kompanitë vizitohen disa herë në vit nga inspektorati i punës për të parë për së afër ti nëse kompanitë janë duke i 'u përmbajtur kërkesave të ligjit për siguri dhe shëndet në punë. Vizita një deri në dy herë në vit raportohet të kenë 55.56% e kompanive të anketuara. Ndërsa tre deri në katër herë në vit inspektorati i punës ka vizituar rreth 39% të kompanive. Vetëm, një pjesë e vogël e tyre nuk janë vizituar nga ky inspektorat, përkatësisht 6% e tyre.




Figura 11: Vizitat në kompani nga inspektorati i punës

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

3.2 Procedurat dhe politikat e sigurisë dhe shëndetit në punë

Ky seksion trajton në detaje çështjet që lidhen me trajnimet, masat parandaluese, procedurat dhe politikat e dokumentuara të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës nga ana e kompanive kosovare.

Mbi gjysma e kompanive pjesëmarrëse në hulumtim kanë deklaruar se posedojnë një politikë të dokumentuar të sigurisë dhe shëndetit në punë. Ndërsa, pjesës tjetër u mungon një politikë e tillë e cila në thelb lehtëson procesin punës së punëtorëve duke e ruajtur shëndetin e tyre dhe shërben si një udhërrëfyes për hapat që ata duhet të ndjekin brenda kompanisë për siguri dhe shëndet.




Figura 12: Politika e dokumentuar e shëndetit dhe sigurisë në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Gjithashtu, dokumentimi i proceseve dhe procedurave për punë të caktuara që punëtorët duhet të përformojnë është shumë i rëndësishëm për orientim të saktë të punëtorëve dhe ndikon shumë në ulje të shkallës së rrezikshmërisë, nga e cila siç duket dhe në të gjeturat e paraqitura në figurën e mëposhtme shumica e kompanive posedojnë pjesërisht ose plotësisht procese dhe procedura të dokumentuara në të cilat mbështeten punëtorët e tyre gjatë realizimit të aktiviteteve të tyre operacionale. Mbi 30% e kompanive të

anketuara theksuan se i kanë të dokumentuara plotësisht proceset dhe procedurat të cilat tregojnë në detaje se si përmbushët një operacion.




Figura 13: Dokumentimi i përmbushjes së një operacioni

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Ngjashëm si në të gjeturat e prezantuara në seksionet paraprake dhe këtu, del se kompanitë që kanë më shumë femra të punësuar i kanë më shumë të dokumentuara proceset dhe procedurat rreth përmbushjes së një operacioni të caktuar. Rrjedhimisht, të gjitha kompanitë që i kanë të punësuar mbi 50 punëtore i kanë të dokumentuara proceset dhe procedurat e punës së tyre. Në bazë të testit statistikor chi square p- vlera është më e vogël se 0.05, që nënkupton se këto të gjetura janë statistikisht të rëndësishme.




Figura 14: Dokumentimi i përmbushjes së një operacioni në bazë të femrave të punësuar në kompani

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	23.595 ^a	6	.001
Likelihood Ratio	25.862	6	.000
Linear-by-Linear Association	15.870	1	.000
N of Valid Cases	139		

Tabela 4: Testi statistikor Chi-Square për testimin e signifkances së të dhënave rreth dokumentimit të mënyrës së përmbushjes së një operacioni nga kompanitë në bazë të numrit të femrave të punësuar

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Induksioni i sigurisë është trajnimi dhe shpjegimi bazë mbi kërkesat themelore të sigurisë që kompania i ka vendosur. Andaj, si pasoj shumica e kompanive kosovare u ofrojnë trajnime punëtorëve të rinj rreth kërkesave themelore që kompania e tyre ka vendosur në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, në mënyrë që punëtorët e tyre pastaj të posedojnë njohuri bazë për ruajtjen e shëndetit të tyre. Respektivisht, rreth 79% kanë potencuar se induksioni i sigurisë i ‘u jepet të gjithë punëtorët e rinj, ndërsa një pjesë prej 16% e kompanive u deklaruan se u japin induksion sigurie shumicës së punëtorëve që janë të punësuar në kompaninë e tyre.




Figura 15: Induksioni i sigurisë për punëtorët

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Kompanitë ndërmarrin masa të ndryshme për të parandaluar aksidentet dhe sëmundjet profesionale në vendin e punës, në mënyrë që të minimizojnë shkallen e rrezikshmërisë deri në një nivel optimal. Masa më e shpeshtë që ndërmarrin rreth 61% e kompanive është miratimi i fazës së kërkimit, projektimit dhe hartimit të planit për përdorimin e pajisjeve të punës, që çojnë në zvogëlimin dhe shmangien e rreziqeve, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Masa tjetër më e shpeshtë që ndërmerret nga 44% e kompanive është përcaktimi i përgjegjësive të punëtorëve për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përshkrimi i punës sipas pozicionit përkatës të punës. Pasuar nga përpilimi i një dokumenti të vlerësimit dhe parandalimit të rrezikut i cili përmban masa me karakter teknik, organizativ, higjieniko-sanitar, masa të cilat zbatohen sipas kushteve specifike të vendeve të punës për veprimtaritë përkatëse, kjo masë është ndërmarr nga 31% e kompanive.

Vetëm 23.78% sigurojnë funksionimin e vazhdueshëm dhe të duhur të sistemeve dhe mjeteve mbrojtëse, mjeteve të matjes dhe të kontrollit, si dhe të pajisjeve të diktimit, mbajtjes nën kontroll dhe neutralizimit të substancave të rrezikshme që lirohen gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike.




Figura 16: Masat parandaluese të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Kompanitë që operojnë në sektorin privat kanë dalje emergjente dhe hapësira të ndryshme të disponueshme në objektin ku ato punojnë. Mbi gjysma e kompanive pjesëmarrëse në hulumtim (64%) kanë theksuar se në ndërtesën ku ata punojnë kanë dalje emergjente, po ashtu një pjesë e madhe (rreth 53.3%) kanë theksuar se kanë hapësirë të mjaftueshme për pushim. Ndërsa, një përqindje më e vogël e kompanive (14%) theksuan se kanë objekte/hapësira për pastrimin dhe dezinfektimin e rrobave të punës dhe pajisjet mbrojtëse në objektin ku punojnë.

Cilat nga opsionet e mëposhtme i keni siguruar apo janë të disponueshme në objektin/ndërtesën ku ju punoni?




Figura 17: Opsionet e disponueshme në kompani në rast rreziku të sigurisë dhe shëndetit

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

3.3 Gjendja aktuale rreth kushteve për sigurinë dhe shëndetin në punë nga ana e punëdhënësve

Në këtë seksion është paraqitur gjendja aktuale e kushteve të punës që kompanitë ofrojnë ndaj punëtorëve të tyre për të arritur siguri dhe shëndet në vendin ku punojnë. Mbi 75% e kompanive të anketuara kanë potencuar se aktualisht përdorin deri në 10% të qarkullimit të tyre për të investuar në përmirësimin e kushteve të punës për sigurinë dhe shëndetin në punë. Ndërsa, vetëm rreth 1% e kompanive deklaruan se përdorin mbi 30% të qarkullimit të kompanisë për të përmirësuar kushtet e punës.




Figura 18: Përqindja e qarkullimit që përdoret për investime të sigurisë dhe shëndetit në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Tendencat e bizneseve për investime në përmirësimin e kushteve të punës në tre (3) vitet e ardhshme duket të jenë shumë pozitive dhe premtuese. Një pjesë e madhe e kompanive, respektivisht 91.6% kanë theksuar se do t'i rrisin investimet në tre vitet e ardhshme me qëllim të përmirësimit të kushteve për sigurinë dhe shëndetin në punë. Ndërsa, në anën tjetër është vetëm një përqindje e vogël (8.5%) e kompanive që kanë potencuar se për arsye të ndryshme nuk do të bëjnë investime të këtij lloji.




Figura 19: Rritja e investimeve në tre vitet e ardhshme

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Shumica e kompanive që operojnë në sektorin privat të Kosovës janë treguar të përgjegjshme duke ndërmarr masa të ndryshme të cilat kontribuojnë në ruajtjen e shëndetit të punëtorëve të tyre. Rreth 87% e kompanive të anketuara kanë marrë masat e nevojshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, rreth 56% e kompanive kanë ofruar informata të nevojshme për punë specifike të punëtorëve. Gjysma e kompanive pjesëmarrëse në hulumtim (50%) u kanë ofruar punëtorëve të tyre trajnime për të bërë një punë të sigurt. Rreth 47% e kompanive kanë ofruar udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës. Gjithashtu, rreth 28% të tjerë u shprehën se kontribuojnë vazhdimisht në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike dhe teknologjike.

Këto të gjetura janë shumë premtuese dhe tregojnë për kujdesin që punëdhënësit kanë treguar për punëtorët e tyre.

Cilat masa i keni ndërmarrë për të siguruar shëndetin dhe sigurinë në punë të punëtorëve tuaj?




Figura 20: Masat e ndërmarra për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

3.4 Gjendja aktuale e zbatimit të udhëzimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë nga ana e punonjësve

Në kuadër të këtij hulumtimi janë analizuar të dy anët e medaljes, pasi është marrë për bazë perspektiva e punëdhënësve dhe perspektiva e punëmarrësve në lidhje me sigurinë dhe shëndetin e tyre në punë. Sipas figurës së mëposhtme, shohim se rreth 75% e kompanive konsultohen rregullisht me punëtorët e tyre për çështjet e sigurisë dhe shëndetit e gjithashtu marrin në konsideratë pikëpamjet e punëtorëve për përmirësimin dhe sigurimin e kushteve të duhura. Pjesa tjetër e kompanive të anketuara (mbi 23%) kanë deklaruar se me raste i përfshijnë pikëpamjet e punëtorëve në këto çështje.




Figura 21: Këshillimi dhe pikëpamjet e punëtorëve për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Kompanitë janë pyetur edhe nëse i inkurajojnë punëtorët të raportojnë shqetësimet që ata kanë në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë, duke përfshirë aksidentet që mund të ndodhin gjatë punës dhe siç mund të shohim nga figura e mëposhtme, të gjitha kompanitë e anketuara (100%) kanë pohuar se i inkurajojnë punëtorët e tyre në raportimin e shqetësimeve të tilla.




Figura 22: Raportimi i shqetësimeve të punëtorëve

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Një shumicë e konsiderueshme prej 80.5% e kompanive të anketuara (shih në figurën 24), u shprehën se punëtorët e tyre i përdorin me korrektësi makineritë, aparaturat, veglat, pajisjet e transportit dhe mjetet tjera për punë, ku gjithashtu gjatë punës së tyre veprojnë me kujdes me substancat e rrezikshme. Një pjesë po ashtu e konsiderueshme (60%) e kompanive deklaruan se përdorin me korrektësi pajisjet mbrojtëse individuale të vëna në dispozicion të punëtorëve të tyre dhe pas përdorimit ata i rikthejnë ato në vendet e caktuara që planifikohen për t'i ruajtur dhe siguruar ato.




Figura 23: Aplikimi i udhëzimeve të punëdhënësit nga punëtorët

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Bashkëpunimi dhe zbatimi i udhëzimeve reciproke në mes të punëdhënësve dhe punëmarrësve janë thelbësore për sigurinë dhe shëndetin në punë. Rreth $\frac{3}{4}$ e kompanive pjesëmarrëse në hulumtim kanë theksuar se punëtorët u përmbahen mesatarisht detyrave dhe udhëzimeve të tyre për ndërmarrjen e masave që sigurojnë shëndetin e tyre. Mbi 27% e kompanive kanë deklaruar se punëtorët u përmbahen mjaft shumë detyrave dhe udhëzimeve të tyre për çështjen e shëndetit dhe sigurisë në punë.




Figura 24: Përmbajtja e detyrave dhe udhëzimeve nga punëtorët për sigurinë dhe shëndetin në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

3.5 Kompetenca e kompanive për sigurinë dhe shëndetin në punë

Në këtë seksion është paraqitur përqindja e kompanive që kanë investuar në trajnimin e punëtorëve të tyre, në posedimin e planeve formale për trajnim dhe në angazhimin e punëtorëve ose eksperteve të jashtëm të licencuar për të kryer veprimtari që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë.

Një e gjetur shumë pozitive e këtij hulumtimi është përqindja e lartë e kompanive (73%) që investojnë në trajnimin e punëtorëve të tyre në mënyrë që ata të posedojnë njohuri bazike rreth çështjeve që lidhen me ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë e tyre.




Figura 25: Investimet në trajnime

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Gjysma e kompanive përpos që ofrojnë trajnime për punëtorët e tyre në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës ato kanë edhe një plan formal të trajnimit të cilin e ndjekin rregullisht.




Figura 26: Plani formal i trajnimit

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Kompanitë të cilat zotojnë një plan formal të trajnimit, janë pyetur edhe nëse e monitorojnë këtë plan dhe mbi gjysma (52%) janë përgjigjur se e monitorojnë vet planin formal të trajnimit.




Figura 27: Monitorimi i planit të trajnimit

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Një përqindje e madhe e kompanive (88%) mbajnë diskutime formale në grup ose trajnime të tjera që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë. Është e vogël përqindja e kompanive që nuk ndjekin një qasje të tillë, rreth 12% (shih në figurën 28).




Figura 28: Mbajtja e diskutimeve formale për sigurinë, ose mbajtja e trajnimeve të tjera nga ana e kompanive

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Pothuajse $\frac{3}{4}$ e kompanive kanë angazhuar punëtorë të kompanisë për të kryer veprimtari nga siguria dhe shëndeti në punë. Ndërsa, rreth 10% kanë angazhuar persona ose kompani që ofrojnë shërbime të specializuara jashtë subjekteve punuese e të cilët janë të kualifikuar dhe të licencuar për të kryer veprimtari në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë.

Cili nga opsionet e mëposhtme aplikohen në kompaninë tuaj?




Figura 29: Angazhimi i punëtorëve për kryerjen e veprimtarive të sigurisë dhe shëndetit në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

3.6 Performanca e kompanive kosovare në raport me sigurinë dhe shëndetin në punë

Një pjesë e konsiderueshme e kompanive të anketuara në terren (53%) matin dhe monitorojnë të gjitha statistikat e sigurisë dhe shëndetit në punë duke përfshirë këtu: aksidentet dhe incidentet e ndryshme në vend të punës. Përderisa, vetëm një e pjesë e vogël e kompanive (5.6%) nuk i monitorojnë këto lloj statistika.




Figura 30: Matja dhe monitorimi i statistikave të shëndetit dhe sigurisë në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Nga pyetja se a vendosin kompanitë objektiva të shëndetit dhe sigurisë, mund të shohim nga figura 31 se 85.3% e kompanive të anketuara kanë objektiva për sigurinë dhe shëndetin në punë.




Figura 31: Objektivat e shëndetit dhe sigurisë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Siç mund të shihet nga figura e mëposhtme një përqindje prej 56% e kompanive të anketuara, e vlerësojnë të mirë performancën e kompanisë së tyre në çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Rreth 23.8% e shohin si të pranueshme performancën e kompanisë së tyre, kurse një pjesë prej 19.6% e kompanive konsiderojnë se kanë performancë të shkëlqyer në çështjet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin.




Figura 32: Performanca e kompanive

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Në bazë të një analize më të detajuar del se kompanitë që kanë të punësuar mbi 50 punëtorë kanë performancë më të mirë sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë në krahasim me kompanitë që kanë më pak punëtorë femra të punësuar. Në bazë të testit statistikor chi square p- vlera është më e vogël se 0.05, që nënkupton se këto të gjetura janë statistikisht të rëndësishme.




Figura 33: Vlerësimi i performancës së kompanive në bazë të numrit të femrave të punësuar

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	29.877 ^a	9	.000
Likelihood Ratio	28.625	9	.001
Linear-by-Linear Association	14.208	1	.000
N of Valid Cases	139		

a. 9 cells (56.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .04.

Tabela 5: Testi statistikor Chi-Square për testimin e signifikances së të dhënave rreth vlerësimit të performancës posedimit të një plani formal të trajnimit në bazë të numrit të femrave të punësuar

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Gjysma e kompanive pjesëmarrëse në studim (50%) kryejnë inspektime në baza të rregullta mujore, mbi 17% kryejnë inspektime ditore dhe javore, përderisa 14% të tjerë nuk bëjnë inspektime të sigurisë dhe shëndetit në punë.




Figura 34: Inspektimet e sigurisë dhe shëndetit në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

3.7 Tendencat e kompanive për përmirësim

Në figurën 35, shohim që një pjesë e madhe e kompanive (64%) kanë një strategji për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve përgjatë aktivitetit të punës, ndërsa më e vogël është përqindja e kompanive që nuk zotojnë një strategji të tillë (36%).




Figura 35: Strategjia e kompanive për siguri dhe shëndet në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Situata është pothuajse e njëjtë dhe me të pasurit e një plani formal për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, ku rreth 69% e të anketuarve u shprehën se kanë një plan për përmirësim. Ndërsa pjesa tjetër (31%) nuk e shohin veten si pjesë të një plani që në të ardhmen do t’iu shërbente në përmirësim të kushteve apo strategjive për sigurinë dhe shëndetin në punë.




Figura 36: Plani për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Rreth 73.5% e kompanive që operojnë në sektorin privat të Kosovës kanë bërë progres të mirë në lidhje me përmirësimin e situatës për sigurinë dhe shëndetin në punë (shih në figurën 40), kurse rreth 23% kanë përparim të ngadalshëm në këtë aspekt. Vetëm, një përqindje shumë e vogël e kompanive u shprehën se kanë përparim të shkëlqyer në përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ndërsa, asnjë kompani nuk ka deklaruar se performanca e tyre është duke u përkeqësuar ose se nuk kanë progres në këtë aspekt.




Figura 37: Përparimi i kompanive në përmirësimin e çështjes së sigurisë dhe shëndetit

3.8 Udhëheqësia e kompanive për trajtimin e çështjeve që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë

Në bazë të të gjeturave të këtij hulumtimi del se pothuajse, udhëheqësit, drejtorët e kompanive dhe pronarët e të gjitha kompanive të intervistuar mbajnë takime të rregullta për të diskutuar çështje që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë. Mbi gjysma e tyre theksuan se mbajnë me raste diskutime të tilla, kurse pjesa tjetër në baza të rregullta.




Figura 38: Takimet për diskutim të çështjeve të sigurisë dhe shëndetit në punë

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

Mbi 50% e kompanive kanë theksuar se udhëheqësit e kompanive së bashku me punëtorët angazhohen dhe kontribuojnë rregullisht në përmirësimin e kushteve që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë (shih figurën 41).




Figura 39: Angazhimi i udhëheqësve për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në vendin e punës

Burimi: Anketa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat të Kosovës.

| 4. Konkluzione

Sfidat lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë vazhdojnë të jenë prezente, mirëpo megjithatë ka pasur dhe përmirësime evidente ndër vite. Pavarësisht që ligjet adekuate nuk mungojnë, ekzistojnë sfida në implementimin praktik të legjislacionit aktual si nga ana e kompanive, të cilat hasin vështirësi të ndryshme për të ofruar kushte të duhura për siguri dhe shëndet në vendin e punës, ashtu dhe nga ana e të punësuarve. Kompanitë, në veçanti ato të vogla dhe të mesme, hezitojnë të investojnë në sigurinë dhe shëndetin në punë si rezultat i kostos së lartë. Duke marrë parasysh se ligji vë barrën kryesore për sigurinë dhe shëndetin në punë mbi punëdhënësin, është e rëndësishme që ky i fundit të përmbushë obligimet e veta. Mirëpo, punëdhënësit nuk janë të vetmit të cilët hasin në vështirësi, pasi që pakujdesia me raste ndodh dhe nga ana e punëmarrësve. Këta të fundit, për shkak të mungesës së trajnimeve adekuate ose vetëdijesimit në këtë aspekt, ndodh që anashkalojnë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse ose respektimin e rregulloreve.

Nga anketimi i kompanive në terren, është kuptuar se ku dhe si qëndron zbatueshmëria ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë, prandaj është *shqyrtuar pyetja se sa i plotësojnë kushtet e punës kompanitë në Kosovë, duke ndërmarrë masat e nevojshme për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe nga rezultati i të gjeturave shohim se përgjigjja ishte 'mesatarisht' nga afro 60% e të anketuarve*. Në bazë të një analize më të detajuar del se kompanitë që kanë më shumë femra të punësuarra kanë plotësuar më shumë kushtet e punës për siguri dhe shëndet në punë se sa kompanitë që kanë më pak ose nuk kanë asnjë femër të punësuar në kompani.

Hulumtimi ka analizuar edhe kompetencat nga ana e kompanive, me fokus çështjen e *investimeve në trajnime për shëndetin dhe sigurinë në punë* dhe në bazë të analizës është kuptuar që *mbi 73% e kompanive të anketuara investojnë në trajnime për të rritur njohuritë bazë të punëtorëve të tyre rreth sigurisë dhe shëndetit në punë*. Megjithatë, ato kanë përmendur se ndër sfidat kryesore me të cilat janë përballur më së shumti në sigurimin e kushteve të duhura janë kostoja e lartë e infrastrukturës së kërkuar për t'i përmbushur kushtet për siguri dhe shëndet (49%), si pengesë e dytë më e raportuar nga kompanitë është kostoja e lartë e trajnimit të punëtorëve (46%), pasuar nga kërkesat e larta dhe të papërbalueshme për infrastrukturë (43%), duke vazhduar me vështirësitë që kompanitë hasin për mbulimin e të gjitha shpenzimeve për kurimin e të punësuarve të

cilët kanë pësuar lëndime në punë apo sëmundje të ndryshme gjatë procesit të punës (40%).

Një tjetër e gjetur mjaft e rëndësishme është se mbi 75% e kompanive të anketuara shfrytëzojnë 0-10% të qarkullimit të tyre për investimet që lidhen me përmirësimin e kushteve në punë për të arritur sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës. Optimizëm shihet të ketë në synimet e kompanive për të rritur investimet në tre vitet e ardhshme në përmirësimin e kushteve të sigurisë dhe shëndetit, këtë e kanë theksuar mbi 91% e kompanive të anketuara.

Performanca e bizneseve në aspektin e sigurisë dhe shëndetit në punë është vlerësuar të jetë e mirë nga ana e kompanive kosovare, pasi që këtë e deklaruar nga rreth 56% e tyre. Kjo është një e gjetur pozitive duke qenë se Kosova qëndron mbrapa nga gjendja ideale e sigurisë dhe shëndetit në punë në krahasim me vendet e zhvilluara. Për më tepër, del se kompanitë që kanë të punësuar mbi 50 punëtore kanë performancë më të mirë sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë në krahasim me kompanitë që kanë më pak punëtore femra të punësuar. Në bazë të testit statistikor chi square p- vlera është më e vogël se 0.05, që nënkupton se këto të gjetura janë statistikisht të rëndësishme.

Është detyrë ligjore e punëdhënësit që të garantojë mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë së punëtorëve, si dhe të konsultohet me punëtorët dhe me përfaqësuesit e tyre dhe t'i lejojë ata që të marrin pjesë në diskutimet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në punë. Afro 47% e kompanive të anketuara kanë deklaruar se udhëheqësit e kompanisë mbajnë rregullisht *diskutime për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë*. Gjithashtu, mund të konkludohet se bizneset e shohin si të rëndësishme çështjen e *përmirësimin të shëndetit dhe sigurisë* ku rreth 70% e kompanive që operojnë në sektorin privat të Kosovës planifikojnë të kontribuojnë në përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit. Nga e tëra kjo duhet të theksojmë se bizneset janë duke bërë progres dita ditës në këtë aspekt dhe se kanë nevojë për më tepër mbështetje nga institucionet e Kosovës dhe palët e interesit.

Kompanitë ndërmarrin masa të ndryshme për të parandaluar aksidentet dhe sëmundjet profesionale në vendin e punës, në mënyrë që të minimizojnë shkallen e rrezikshmërisë deri në një nivel optimal. Masa më e shpeshtë që kanë ndërmarr rreth 61% e kompanive është miratimi i fazës së kërkimit, projektimit dhe hartimit të planit për përdorimin e pajisjeve të punës, që çojnë në zvogëlimin dhe shmangien e rreziqeve, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

| 5. Rekomandime

Ky studim ofron një pasqyrë të qartë mbi gjendjen aktuale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës në sektorin privat të Kosovës në të cilin janë analizuar dimensione të ndryshme që prekin drejtpërdrejt sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve. Andaj, duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe ndikimin e bizneseve, punëtorëve dhe institucioneve shtetërore që kanë në përmirësimin e situatës aktuale sa i përket sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, më poshtë janë paraqitur disa rekomandime drejtuar atyre.

– *Bizneset*

- a) Bizneset e mëdha duhet të vazhdojnë të përmirësojnë kushtet e punës për siguri dhe shëndet të punëtorëve të tyre.

Siguria dhe shëndeti i punëtorëve është një vlerë e shtuar e ndërmarrjes dhe dëshmi që ndërmarrja ka arritur në një nivel të kënaqshëm të performancës. Kjo mund të shërbej si një dëshmi dhe avantazh në raport me ndërmarrjet e jashtme, të cilat mund të kenë interes të investojnë në Kosovë ose të krijojnë një bashkëpunime me kompani vendore.

- b) Bizneset e vogla, duhet të fillojnë të japin kontributet bazike rreth sigurisë dhe shëndetit në punë.

Pavarësisht, vështirësive financiare që mund të kenë ndërmarrjet mikro dhe të vogla, ato duhet të vazhdojnë të kontribuojnë në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtorëve të tyre. Natyrisht, fillimisht duhet të plotësojnë obligimet bazike duke u ofruar punëtorëve të tyre informatat e nevojshme dhe pastaj duke vazhduar me plotësimin e kushteve dhe obligimeve tjera që rrjedhin nga ligji për siguri dhe shëndet në punë. Punëtorëve duhet t'u sigurohen materialet mbrojtëse bazike dhe udhëzimet me shkrim dhe figura në mënyrë që ata vazhdimisht të kenë qasje në këto materiale mbrojtëse dhe informata se si duhet të mbrohen. Në vazhdimësi, duhet të kujdesen që asnjë rast të mos përfundojë me aksident fatal, sepse përpos humbjes së jetës e cila nuk ka çmim, pasojnë edhe dënimet nga institucionet përkatëse për aksidente fatale që janë shumë të larta dhe të papërbalueshme për këtë kategori të bizneseve.

– *Punëtorët*

Punëtorët duhet të jenë më të përgjegjshëm dhe t'i respektojnë udhëzimet për siguri dhe shëndet në punë. Përvoja ka treguar, se në disa ndërmarrje, materialet dhe informatat udhëzuese janë siguruar nga punëdhënësi, mirëpo si rezultat i mosrespektimit të masave nga ana e punëtorëve, ka rezultuar me aksident e në raste të caktuara me fatalitet. Punëtorët duhet të jenë te vetëdijshëm që në rast të mosrespektimit të udhëzimeve pasojat duhet t'i bartin vet ata.

– *Qeveria/Inspektorati/organizatat biznesore*

- a) Mbështetja e bizneseve për plotësimin e kushteve për siguri dhe shëndetin në punë

Institucionet dhe organizatat biznesore duhet të jenë përkrah bizneseve në ofrimin e informatave dhe obligimeve që rrjedhin nga dokumentet ligjore. Gjithashtu, Qeveria duhet të gjejë modalitete që të përkrah bizneset në plotësimin e kushteve për siguri dhe shëndetin në punë, me theks të veçantë, përkrahja duhet të shkoj për ndërmarrjet mikro dhe të vogla.

b) *Fushata vetëdijësuese për të gjitha palët*

Tanimë, një kohë të gjatë janë organizuar aktivitete të ndryshme të cilat kanë pasur për qëllim vetëdijësimin e palëve të interesit. Megjithatë, rekomandojmë që fushata vetëdijësuese të jetë në vazhdimësi dhe mos të jetë rezultat i aktiviteteve ad hock apo projekteve të caktuara. Ekonomia po zhvillohet, ndërmarrje të reja po themelohen dhe njerëz të rinj po futen në proces prandaj për këtë arsye duhet të ketë aktivitete të rregullta, në mënyrë që informatat për sigurinë dhe shëndetin në punë të shpërndahen në masë më të madhe.

- c) Inspektorati i punës duhet të përdorë si mjet kryesor informimin, mentorimin dhe në fund të orientohet drejt masave ndëshkuese. Duhet t'u jepet rast bizneseve dhe kohë që siguria dhe shëndeti në punë të jenë pjesë e politikave zhvillimore të biznesit.

Shtojca 1

Pyetësor për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sketorin Privat të Kosovës

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësoj gjendjen aktuale të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe si dhe të identifikoj nevojat dhe sfidat e me të cilat përballën kompanitë në Kosovë.

Siguria dhe shëndeti në punë – është pjesë përbërëse e organizimit të procesit të punës, duke ndërmarrë masat parandaluese, që kanë synim përmirësimin e kushteve të punës, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, përmirësimin e ambientit të punës, mbrojtjen fizike dhe psikike të punësuarëve dhe të tjerëve që marrin pjesë në procesin e punës.

KAPITULLI 1: VLERËSIMI I BAZËS LIGJORE (ZBATIMI DHE SFIDAT)

1. Sa keni njohuri për kërkesat që rrjedhin ndaj punëdhënësve nga ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë?
 - Shumë pak
 - Pak
 - Mesatarisht
 - Shumë
2. Sa i plotësoni kushtet e punës duke ndërmarr masat e nevojshme për sigurinë dhe shëndetin në punë?
 - Shumë
 - Mesatarisht
 - Pak
 - Aspak
3. Sa të vështirë e keni ti zbatoni detyrimet që rrjedhin nga ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë?
 - Shumë
 - Mesatarisht
 - Pak
 - Aspak
4. Cilat janë sfidat me të cilat përballeni gjatë zbatimit të ligjit për shëndetin dhe sigurinë në punë?
 - Kërkesat e larta për infrastrukturë

- Kosto e lartë e infrastrukturës së kërkuar për të arritur sigurinë dhe shëndetin në punë
- Kosto e lartë e trajnimit të punëtorëve për sigurinë dhe shëndetin në punë
- Punëtorët nuk u binden kërkesave
- Vështirësi në mbulimin e të gjitha shpenzimeve për kurimin e të punësuarit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale.
- Kosto e lartë për të përmirësuar kushtet e punës dhe për të ndërmarr masat e duhura
- Vështirësi në pajisjen e punëtorëve me mjetet dhe pajisjet e duhura profesionale të punës si dhe aparaturat matëse adekuate.

5. Sa shpesh vizitohet kompania juaj nga inspektorati i punës ?

- 1 – 2 herë në vit
- 3 – 4 herë në vit
- Asnjëherë

6. A keni ndonjë qështje ose problem me inspektoriatin e punës?

KAPITULLI 2: PROCEDURAT DHE POLITIKAT E SHËNDETIT DHE SIGURISË

7. A ka kompania juaj një politikë të dokumentuar të shëndetit dhe sigurisë?

- Po
- Jo

8. A keni të dokumentuara procese dhe procedura të cilat e tregojnë me detaje se si të përmbushet një operacion?

- Po
- Pjesërisht
- Jo

9. A u jepni punëtorëve një induksion sigurie kur ata fillojnë punë në kompaninë tuaj? (Induksioni i sigurisë është trajnimi dhe shpjegimi bazë për punëtorët e rinj mbi kërkesat themelore të sigurisë që kompania ka vendosur)

- Po, për të gjithë punëtorët e rinj
- Po, për shumicën e punëtorëve
- Po, me raste
- Jo

10. Cila masa për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale i aplikoni?

- Miratojmë fazën e kërkimit, të projektimit dhe hartimit të planit për përdorimin e pajisjeve të punës, që çojnë në zvogëlimin dhe shmangien e rreziqeve, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;
- Përpilojmë një dokument vlerësimi dhe parandalimi të rrezikut që përmban masat me karakter teknik, organizativ, higjieniko-sanitar, të cilat do të zbatohen sipas kushteve specifike të vendeve të punës për veprimtarinë përkatëse;
- përcaktojmë cilësitë dhe përgjegjësitë e të punësuarit në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë, në përshkrimet e punës, sipas pozicionit përkatës të punës;
- ndërmarrim masat për të siguruar materialet e nevojshme për informimin dhe trajnimin e të punësuarve dhe të vendosim shenjat adekuate për siguri, postera, fletushka, filma, filmime të lidhura me sigurinë dhe shëndetin në punë;
- sigurojmë funksionimin e vazhdueshëm dhe të duhur të sistemeve dhe mjeteve mbrojtëse, mjeteve të matjes dhe të kontrollit, si dhe të pajisjeve të diktimit, mbajtjes nën kontroll dhe neutralizimit të substancave të rrezikshme që lirohen gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike.

11. Cilat nga opsionet e mëposhtme i keni siguruar apo janë të disponueshme në objektin/ndërtesën ku ju punoni?

- Ndërtesa ka daljet emergjente;
- Kemi planin për evakuim në mënyrë që të punësuarit të evakohen nga objekti/ndërtesa, në rastin e ngjarjeve të papritura, prej të cilave rrezikohet jeta dhe shëndeti i tyre;
- Rrugët dhe daljet emergjente janë të shënuara qartë me shenja adekuate, të cilat janë të vendosura në vende të dukshme
- Rrugët dhe daljet emergjente të jenë të lira, pa pengesa dhe të cilat të dërgojnë direkt jashtë zonës së rrezikshme apo në një zonë të sigurt;
- Hapësira për dhënien e ndihmës së parë dhe pajisjet e nevojshme janë të disponueshme
- Ka hapësirë të nevojshme për pushim

- Ka hapësira ndihmëse (dhoma për ushqim, dhoma e veshjeve/garderoba, banjo, tualetet ndaras për femra dhe meshkuj);
- Ka objekte/hapësira për pastrimin dhe dezinfektimin e rrobave të punës dhe pajisjet mbrojtëse.

KAPITULLI 3: VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE TË PUNËDHËNËSVE

12. Sa përqind të qarkullimit tuaj e përdorni për investimet që lidhen me përmirësimin e kushteve në punë për ta arritur sigurinë dhe shëndetin në punë ?

- 0 - 10 %
- 11 – 20 %
- 21 – 30 %
- Mbi 30 %

13. A synoni të rritni investimet në tre (3) vitet e ardhshme në përmirësimin e kushteve për sigurinë dhe shëndetin në punë?

- Po
- jo

14. Cilat masa i keni ndërmarr për të siguruar shëndetin dhe sigurinë në punë të punëtorëve tuaj?

- Masat e nevojshme për parandalimin e rreziqeve profesionale
- Sigurimin dhe ofrimin e informative të nevojshme për punët specifike të punëtorëve
- Trajnimin e të punësuarve për të bërë një punë të sigurtë
- Kemi ofruar udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës
- Kemi ndërmarr masat e duhura për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës
- Kontribuojmë vazhdimisht në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike – teknologjike
- Ne si punëdhënës jemi përgjigj për të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën

KAPITULLI 4: VLERËSIMI I SITUATAVE AKTUALE (PUNONJËSIT)

15. A këshilloheni me punonjësit tuaj për qështjet e shëndetit dhe sigurisë?

(A i përfshini dhe merrni në konsideratë pikëpamjet e punëtoreve në përmiresimin e shëndetit dhe sigurisë dhe mënyren se si te arrihet kjo)

- Po, rregullisht
- Po, me raste
- Jo

16. A i inkurajoni punëtorët tuaj të raportojnë shqetësimet në lidhje me shëndetin dhe sigurinë, si përshembull aksidentet?

- a. Po
- b. Jo

17. Cilat nga opsionet e mëposhtme aplikojnë punëtorët në përputhje me udhëzimet tuaja?

- përdorin me korrektësi makineritë, aparataturat, veglat, pajisjet e transportit mjetet tjera për punë dhe të veprojnë me kujdes me substancat e rrezikshme;
- përdorin me korrektësi pajisjet mbrojtëse individuale të vëna në dispozicion të tyre dhe pas përdorimit t'i rikthejnë ato në vendin që është planifikuar për ruajtjen e tyre të sigurt;
- njoftojnë menjëherë personin e ngarkuar për qështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit e të punësuarve, për çdo situatë pune, për të cilën kanë një motiv të arsyeshëm për ta vlerësuar si rast që paraqet një rrezik të rëndë dhe të menjëhershëm për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- respektojnë të gjitha detyrimet e përcaktuara nga ana jonë si punëdhënës për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, në të kundërtën ata do të jenë përgjegjës për dëmin ose aksidentin e shkaktuar.

18. Sa i përmbahen punëtorët detyrave dhe udhëzimeve tuaja për ndërmarrjen e masave për sigurinë dhe shëndetin në punë?

- Shumë
- Mesatarisht

- Pak
- Aspak /nuk u përmbahen

KAPITULLI 5: KOMPETENCA

19. A investoni në trajnime?

- Po
- Jo

20. A ka kompania juaj një plan formal të trajnimit?

- Po
- Jo

21. A e monitoroni këtë plan?

- Po
- Jo

22. A mban kompania juaj diskutime formale ne grup qe lidhen me sigurine, ose trajnime të tjera?

- Po
- Jo

23. Cili nga opsionet e mëposhtme aplikohen në kompaninë tuaj?

- Kemi angazhuar punëtor të kompanisë për të kryer veprimtarinë nga siguria dhe shëndeti në punë
- Kemi angazhuar persona ose shërbime të specializuara jashtë subjekteve punuese të kualifikuar dhe të licencuar, për të kryer veprimtarinë nga siguria dhe shëndeti në punë
- Nuk kemi angazhuar askënd për të kryer veprimtarinë nga siguria dhe shëndeti në punë

KAPITULLI 6: MATJA E PERFORMANCËS

24. A i mat dhe monitoron kompania juaj statistikat e shëndetit dhe sigurisë si për shembull: aksidentet, incidentet e ndryshme etj.

- Po, të gjitha
- Po, disa
- Jo

25. A vendos kompania juaj objektiva të shëndetit dhe sigurisë?

- Po

- Jo

26. Sa mendoni që është e mirë performanca e kompanisë suaj në qështjet e shëndetit dhe sigurisë?

- E shkëlqyer
- E mirë
- E pranueshme
- E dobët

27. A kryen kompania juaj inspektime të shëndetit dhe sigurisë?

- Po, çdo ditë
- Po, javore
- Po, mujore
- Jo

KAPITULLI 7: PLANI PËR PËRMIRËSIM

28. A ka kompania juaj një strategji për shëndet dhe siguri?

- Po
- Jo

29. A ka kompania juaj një plan për përmirësimin e shëndetit dhe sigurisë?

- Po
- Jo

30. A po bën përparime kompania juaj në përmirësimin e qështjes së shëndetit dhe sigurisë, si do ta përshkruanit këtë?

- Përparim i shkëlqyer
- Përparim i mirë
- Përparim i ngadalshëm
- Nuk ka përparim
- Duke u përkeqësuar

KAPITULLI 8: UDHËHEQËSIA DHE QEVERISJA

31. A mbajnë takime të rregullta udhëheqësit, drejtorët e kompanisë dhe pronarët për të diskutuar qështjet e shëndetit dhe sigurisë?

- Po, rregullisht
- Po, me raste
- Asnjëherë

32. A angazhohen udhëheqësit e kompanisë me punëtorët në lidhje me shëndetin dhe sigurinë?

(Siguria e punëtorëve në vendin e punës)

- Po, rregullisht
- Po, me raste
- Asnjëherë

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Emri i kompanisë:

Email:

Nr. Telefonit:

Madhësia e kompanisë:

33. Sa femra janë të punësuar në kompaninë tuaj?

34. Sa punëtor keni të punësuar?

- 1-9 punëtorë
- 10-49 punëtorë
- 50-249 punëtorë
- Mbi 250 punëtorë

35. Në cilin rajon operoni?

36. Në cilin sektor operoni?

Anketuesi _____

